

AXHENDA

ANKETA E ETF-SË MBI KONTRIBUTIN E ORGANIZATAVE TË
SHOQËRISË CIVILE NË ZHVILLIMIN E KAPITALIT NJERËZOR NË
KONTEKSTIN E TË MËSUARIT GJATË GJITHË JETËS

TAKIM NË PLATFORMËN ZOOM

24 MARS 2021, ORA 11.00 CET

PËRMBLEDHJE

Kriza e Covid 19 ka sjellë në fokus faktin se Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) luajnë një rol jetik duke vazhduar mbështetjen e tyre për të mësuarin joformal dhe informal të njerëzve. Ndalimi ose kufizimi i lëvizjes së njerëzve po e ndryshojnë ndjeshëm kontekstin në të cilin operojnë OSHC-të. Edhe pse shpesh situata perceptohet si bllokim i shumë projekteve dhe aktiviteteve të vazhdueshme, ajo mund edhe të nxisë zhvillime të reja, kreativitet dhe të ofrojë mundësi të reja për OSHC-të.

Ky është një nga rezultatet e anketës së Fondacionit Evropian të Trajnimit të zhvilluar në vitin 2020 mbi kontributin e OSHC-ve në Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor në kohën e krizës së Covid 19.

Kjo anketë mbuloi Shqipërinë, Jordaninë, Serbinë, Tashikistanin, Ukrainën, Uzbekistanin dhe pati me qëllim:

- Vlerësimin e dinamikës së kapacitetit operacional të OSHC-ve për të vlerësuar qëndrueshmërinë e tyre, në veçanti raportin mes të qenit proaktive dhe thjesht

reaguese në kohë emergjence, kapacitetin për të mobilizuar burime (njerëzore, financiare), aftësinë për të adresuar kërkesat e reja, kapacitetin për novacion dhe për t'u paraprirë zhvillimeve,

- Analizimin e komplementaritetit të veprimit të OSHC-ve me masat e qeverisë qendrore dhe vendore për arsimin dhe punësimin në përgjigje të pandemisë,
- Vlerësimin nëse kriza e Covid 19 po ndryshon rolet dhe fushën e veprimit të punës së OSHC-ve, pas angazhimit të tyre të intensifikuar gjatë krizës,
- Mbledhjen e reagimeve (feedback) nga nxënësit mbi efektivitetin e OSHC-ve,
- Vendosjen e kontakteve me një rrjet OSHC-sh që operojnë në fushën e të mësuarit gjatë gjithë jetës, AFP joformal dhe informal, përvetësimin e aftësive dhe shërbimet e punësimit në gjashtë vende.

Fondacioni Evropian i Trajnimit së bashku me Agjencinë **për Mbështetjen e Shoqërisë Civile të Republikës së Shqipërisë** organizojnë një takim online më **24 Mars 2021, ora 11.00am CET** për të prezantuar gjetjet e kësaj ankete në Shqipëri dhe analizën paraprake të vendeve të përfshira në të. Ky takim ofron një mundësi për të diskutuar rezultatet e anketës dhe për të reflektuar bashkërisht mbi kontributin e OSHC-ve në mësimin gjatë gjithë jetës me përfaqësues të OSHC-ve, politikëbërës, organizata donatore dhe aktorë të tjerë të interesuar.

Takimi do të zhvillohet në platformën Zoom in gjuhën angleze/shqipe, me përkthim silmultan.

TAKIMI NË ZOOM — 24/03/2020

11:00 — 13:40 CET

	Përmbajtja
10:50 – 11:00	Hapja e takimit në Zoom për pjesëmarrësit
11:00 – 11:15	Mirëseardhja dhe Prezantimet, Dajna Sorensen, Zëvendësministre, Ministria e Financave dhe Ekonomisë Hugues Moussy, Shef i Njësisë së Performancës dhe Vlerësimit të Sistemeve, Departamenti i Qendrës së Njohurive, ETF Andi Kananaj, Drejtor Ekzekutiv i AMSHC Moderatore: Nadezda Solodjankina, ETF, specialiste e ZHKNJ, ETF
11:15 – 11:30	Zhvillimet e fundit dhe perspektivat e ardhshme të punës së OSHC-ve në Shqipëri, prezantim i AMSHC-së pasuar nga një seksion Pyetje-Përgjigjesh
11:30 – 11:40	OSHC-të dhe Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor në kushtet e COVID-19 në Shqipëri- Objektivat dhe metodologjia e anketës së ETF-së Siria Taurelli, ETF, Specialiste për Qeverisjen dhe të Mësuarin gjatë Gjithë Jetës, ETF
11:40 – 12:00	OSHC-të dhe Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor në kushtet e COVID-19 në Shqipëri - Gjetjet e anketës së ETF-së Entela Kaleshi, eksperte vendase
12:00 – 12:15	Pyetje & Përgjigje
12.15-12.20	Prezantimi i punës në grupe dhe pushim i shkurtër
12.20– 12.45	Puna në grupe (Breakout sessions) sipas temave të anketës: <ul style="list-style-type: none"> ➤ Grupi 1: Shkëmbimi i përvojave lidhur me Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor në kohën e COVID19 - Çfarë funksion dhe çfarë jo (vetëm në anglisht) ➤ Grupi 2: Roli vendimtar i OShC-ve në përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të politikave publike në fushën e ZHKNJ (anglisht/shqip, me përkthim simultan) ➤ Grupi 3: Dialogu i OSHC-ve me aktorët institucionalë dhe politikëbërësit (vetëm shqip)
12.45 – 12.50	Raportimi i përfundimeve të punës në grupe në seancën plenare (1 përfaqësues nga secili grup do të prezantojë rezultatet kryesore të diskutimit - 1.5 minuta secili)
12.50-13.10	Analiza e kontributit të OSHC-ve në zhvillimin e kapitalit njerëzor në kontekstin e të mësuarit gjatë gjithë jetës në vendet e anketuara Stylianos Karagiannis, ETF, Statisticien dhe analist të dhënash, ETF

13:10 – 13:20	Pyetje & Përgjigje
13.20-13-40	Diskutim i hapur dhe Përmbledhje Moderatore: Siria Taurelli, ETF, Specialiste e Lartë për Qeverisjen dhe të Mësuarin gjatë Gjithë jetës, ETF